

AKT - THEMELIMI

(KONTRATE)

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

(SH P K)

" JONIX" SH P K

Une, Ilirjan Xhixha i biri i Nebiut, idtl.1966, banues ne lagje " Zef Hoti " Mamurras rrethi Kurbin, ne baze te legjislacionit shqiptar vendosa:

NENI 1

Te themeloi nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, per te ushtruar veprimtari ekonomike e emruar "JONIX" sh p k, me ortak te vetem Z. Ilirjan Xhixha.

NENI 2

Shoqeria do te jete e formes tregtare (shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar), dhe perballon humbjet, deri ne kufirin e vleres se derdhur ne kapitalin themeltare.

NENI 3

Shoqeria ka seline e saje ne Mamurras lagje "Zef Hoti". Ajo ka te drejte te krijojte brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filjale agjensi, perfaqesi, seli sekondare si dhe te suprimoje ato.

NENI 4

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje me kufi te pa caktuar e mbi 10 vjete. Ajo munde te shperbehet ne çdo kohe me vendim te ortakut te vetem,

NENI 5

Kapitali fillestare themelore i shoqerise do te jete 100 000 (njeqinte mije leke), kapital i cili eshte formuar teresishte nga ortakut i vetem themelues i saje.

NENI 6

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne shoqeri, do te shenohet edhe kapitali i derdhur nga ortaku. Rritja e kapitalit te ortakut nuk eshte i kufizuar.

NENI 7

Te gjitha pjeset e kapitalit themelore, jane teresishte te shlyeshme e te neneshkrueshme nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 8

OBJEKTI I AKTIVITETIT EKONOMIK TE SHOQERISE DO TE JETE:

NE FUSHEN E TRANSPORTEVE RRUGORE.

- Transporti i udhetareve me autobus brenda vendit (qytetes, rreth qytetes, nderqytetes, transport i lire).
- Transport nderkombetare me autobus.

- Transport me taksi.
- Transport mallra (brenda vendit, nderkombetare, me qira dhe per te trete, per vete, te rrezikeshme).

NE FUSHA TE TJERA.

- Tregti me pakice e shumice.
- Import eksport.
- Prodhim e tregtim produkte bujqesore e blegtorale.

NENI 9

Marrdhenjet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet, kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Ligjit 7961 dt. 12.07.1995 te (Kodit te Punes), si dhe te akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tije dhe kontratave.

NENI 10

Ortaku i vetem nuk kufizohet ne rritjen e kapitalit te shoqrise.

NENI 11

Shoqria vepron ne regjimin e prones private, dhe merr per siper te drejta dhe detyrime, vetem brenda kufirit te kapitalit te saje. Ortaku i vetem themelues mbast rrezikun e veprimtarjse se shoqrise vetem, ne nivelin e kapitalit te investuar ne shoqri.

NENI 12

Mosmarrveshjet qe munde te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te shoqerise, midis punonjesve te saje me ortakun dhe me te trete, kur ato nuk munde te zgjidhen me mirekuptim, ceshtja mbetet ne kompetence te Gjykates se rrethit Tirane, ku do te jete edhe regjistri tregtare i saje.

NENI 13

Shoqeria do te kete vulen e saje, ku jane percaktuar dhe inici- alet e emertimit te saje.

NENI 14

Pasuria e shoqerise munde te sigurohet prane Institutit te Sig. Shoqr.

NENI 15

Organet e shoqerise "JONIX" jane:

Ortaku i vetem i shoqerise. Administrator shoqerie ortaku i vetem. Modalitetet e formimit dhe funksionimit te organeve drejtuese e organizuese te kesaj shoqerie, do te percaktohen ne Statutin e Shoqerise.

Administrator i shoqerise do te jete Z. Ilirjan Xhixha.

Modalitetet per ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tije, rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji 7638 dt. 19.11. 1992 "Per shoqerite Tregtare".


Ky akt themelimi eshte perpiluar ne 4 kopje me vlere te njejte me origjinalin.

Laç, me 27.02. 2008 (nje)

THEMELUESI

ORTAK DHE ADMINIS.I VETEM

Ilirjan XHIXHA



S T A T U T

I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

" J O N I X " S H P K

Shoqeria "JONIX" është krijuar mbi bazen e Aktit të Themelimit, të ortakut të vetem Ilirjan Xhixha, i biri i Vebiut lindur më 1966, bashkë me lagj "Zef Hoti" të qytetit Mamurras, për të zhvilluar aktivitetet tregëtare në fusha të ndryshme, e cila ka vendosur të perpilojë këtë Statut si më poshtë:

NENI 1

EMERTIMI

Shoqeria është quajtur " J O N I X " S H P K.

Ajo është një person juridik shqiptarë e cila do të zhvillojë aktivitet privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, pas regjistrimit në regjistrin tregëtarë pranë Gjykatës së rrethit Tirane. Shoqeria "JONIX" do të zhvillojë aktivitetin e sajë, në përputhje me legjislacionin shqiptarë dhe me Akt themelimit të Statutit të sajë.

Ortaku i vetëm themelues në këtë sipërmarrje, ka derdhur kapitalin e tijë, me qëllim që të përfitojë të ardhura, që mundë të vijnë nga ushtrimi i veprimtarisë private si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlefës së derdhur të kapitalit themelues.

NENI 2

OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë "JONIX" do të jetë:

NE FUSHEN E TRANSPORTEVE RRUGORE:

- Transport i udhëtarëve me autobus brenda vendit (qytetës, rrethqytetës, ndërqytetës, transport i lire).
- Transport ndërkombëtarë me autobus.
- Transport me taksë.
- Transport mallra (brenda vendit, ndërkombëtarë, me qerë dhe për të tretë, për vetë, të rrezikëshme).

NE FUSHA TE TEJRA:

- Tregëti me pakicë e shumicë.
- Import eksport.
- Prodhim e tregëtim produkte bujqësorë e blegtoralë.

NENI 3

Për kryerjen e veprimtarisë së sajë, shoqëria do të hapë njësi, shërbime, tregëtime, përpunime, grumbullime, riparime, axhënsi etjër, duke bashkëpunuar me persona juridik ose fizik, vendas e të huaj.

NENI 4

SELIA

Shoqëria "JONIX" e ka selinë e sajë në lagj "ZEF HOTI" të qytetit Mamurras, ajo ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë degë, filjale, axhënsi, përfaqësi si dhe të suprimojë ato.

NENI 5

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Shoqeria private "JONIX", do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise ekonomike te saje me nje kufi te pa caktuar e mbi 10 vjete dhe munde te shperbehet ne çdo kohe, per çfardo shkak.

NENI 6

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali fillestare i shoqerise eshte 100 000 (njeqintemije) lekë. e perbere nga kuota e ortakut te vetem themelues Ilirjan Xhixha, zotues i vetem i ketije kapitali themeltare dhe ortak i vetem.

NENI 7

Pjeset e kapitalit themelore jane plotesishte te transferueshme ne rruge trazhgimie, ne raste ndarje pasurore ndremjet bashkeshorteve paraardhesve e pasardhesve.

Te gjitha pjeset e kapitalit te shoqerise munde tu kalojne, t'u tre transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne ortakeri, por gjithmone me vendim te ortakut te vetme dhe me akt noterial.

Trazhgimtari hyn ne shoqeri me te gjitha te drejtat e ortakut dhe me te gjitha efektet.

NENI 8

Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali themelore dhe te tjera te nevojsheme per ushtimin e veprimtarise tregtare.

Te gjitha pjeset e kapitalit themelore jane teresishte shlyeshme dhe te neneshkrueshme nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 9

Fitimi i realizuar nga ushtimi i veprimtarise ekonomike te shoqerise, do te administrohet nga ortaku i vetem.

Nje pjese e ketije fitimi munde te prdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtare. Shoqeria eshte e detyruar te shlyej te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.

NENI 10

ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NE SHOQERI

Organi vendimore jane, vendimet e ortakut te vetem, qe zevendeson Asamblene e ortakeve.

Ortaku i vetem ka te gjitha te drejtat qe ka asambleja e ortakeve. Ortaku i vetem vendos per te tilla: shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndryshimet ne statut, zvoglimi i kapitalit themelore ose zmadhimi i tije, transferimi i pjesve te kapitalit themelore tek te trete, ndryshim te veprimtarise se saje, apo likuidimi i saje, shendrrimi i shoqerise ne nje forme tjeter (ne nje nga format e parashikuara nga ligja, ndryshimi i vendit te selise.

NENI 11

Ortaku i vetem, mbledhjet e zakoneshme i bene çdo vit brenda 4 muajve, nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

ADMINISTRATORI

NENI 12
 Administratori qendron per nje periudhe 3 vjeçare ne detyre, mandati i tije munde te jete i rinovueshem. Ortaku e sezon te drejten ne çdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emroje nje tjetër ne vende te tije. Administratori munde te emroje ne çdo kohe nje zevendes, ta revokojë dhe te emroje nje tjetër ne vende te tije.

Administratori ka keto kompetenca:

Percaktimin e orjentimeve kryesore te programit te buxhetit.

Miratimin e planeve e te llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne baze te aktivitetit te shoqerise.

NENI 13 VITI FINANCIARE LLOGARITE VJETORE DHE REZERVA E DOMOSDOSHME

Çdo vit financiare fillon me 1 janare dhe mbaron me 31 dhjetor, me perjashtim te vitit te pare, ku si fillim eshte data e regjistrimit te shoqerise.

NENI 14

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiare dhe raportet e veçanta te hartuara nga administratori, apo nga ekspertet kontabel, miratohen nga ortaku i vetem, miratimi i dokumentave financiare vjetore behet brenda afatit 3 mujore, te mbylles se vitit financiare.

NENI 15

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit, munde te krijojë edhe fonde te tjera.

Shoqria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se sigurimeve shoqerore etj. ajo ka te drejte te çele llogari likuiduese prane bankave te vendit dhe te kryej veprime likuidimi me to.

NENI 16 MARRDHENJET E PUNESIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE

Marrdhenjet e punesimit brenda shoqrise rregullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis palve ne perputhje me ligjin nr. 7961 dt.12.07.1995(Kodi i Punes) si dhe legjislacionit tjetër shqiptare qe ben fjale per punesimin.

NENI 17

Marrja ne pune behet me regjistrimin nga punedhenesi ne librin e punes te shoqrise, si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku ushtron veprimtarine shoqria.

NENI 18

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes, per shkelje disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit. Largimi nga shoqeria behet mbasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale e monetare.

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti

me shkrim te leshuar nga ortakut themelues i vetem.

NENI 19

Shoqeria munde te lidhe kontrate me sektore shteterore si dhe me persona fizik e juridik te tjere vendas e te huaji.

Ne veprimet kontraktuale shoqria perfaqsohet nga ortakut i vetem, i saje ose nga nje person tjetër i autorizuar me prokure prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqrine.

NENI 20

Shoqria hyn ne proces likuidimi qe ne momentin e prishjes se saje, per kryerjen e ketij procesi, emrohet nje ose disa likuidator te cilet ndjekin operacionet e likuidimit deri ne funde dhe iparaqesin ortakut te vetem dhe administratorit rezultatet perfundimtare te likuidimit. Ne perfundim ortakut i vetem vendos per heqjen e mandatit te tyre, Te gjithë detyrimet qe dalin nga likuidimi i ortakut te vetem dhe administrator i mere per siper per ti shlyer me kapitalin e vete.

NENI 21

Te gjitha mosmarrveshjet qe munde te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise te shoqrise, kur ato nuk munde te zgjidhen me mirkuptim, do te kalojne ne kompetence te Gjykates se rrethit Tirane.

NENI 22

Transferimi i shoqrise nga nje forme ne nje tjetër, behet me vendim te ortakut te vetem, kur plotson kushtet per krijimin e tyre.

NENI 23

Themeluesi i shoqrise munde te beje ndryshime e plotsime ne statutin dhe ne Aktin e themelimit, pa rrene ndeshe ne menyre thelbesore ne çdo kohe, me nenet e pershkruara ne kete statut. Ndryshimet e plotsimet behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxiret vete Statuti.

NENI 24

Asnje lloje aktiviteti nuk do te filloje pa miratimin e lejeve teknike e profesionale te organeve kompetente.

NENI 25

Çeshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete Statut, gjithshka i referohet Ligjit 7638 dt. 19.11.1992, Ligjit 7667 dt. 28.01.1993, si dhe legjislacionit shqiptare ne fuqi dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

NENI 26

Ky statut eshte perpiluar e firmosur ne kater kopje me vlere te njejte me origjinalin.

Laç, me 27.02.2001

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Ilirjan XHIXHA